

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhjet vendore 2023

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi OSBE/ODIHR	Statusi implementimit	Komente dhe shënime të tjera
22	Autoritetet shtetërore duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe vërtet të larmishëm, pa ndikime nga politika dhe biznesi. Parlamenti duhet të ndryshojë Ligjin për mediat audiovizive për të kufizuar përqendrimin e pronësisë së mediave në sektorin e transmetimit dhe të paraqesë masa për të parandaluar ndikimin e padrejtë të pronarëve të mediave mbi politikën editoriale.	Progres i Munguar	Ndryshime dhe shtesa në ligjin për mediat audiovizive private janë një rrugë që mund të ndiqet. Efekt të ndjeshëm mund të japin ndryshimet dhe shtesat që mund të bëhen në Kodin zgjedhor në dispozitat që trajtojnë të drejtën e partive politike për të pasqyruar fushatën e tyre elektorale ose për të dhënë mesazhe për zgjedhësit nëpërmjet transmetimit të kasetave të përgatitura prej tyre. Legjislacioni mund të parashikojë ashpërsim të penalteteteve për pronarët e mediave në rastet e shkeljeve që identifikon AMA.